



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Raporti Vjetor 2019

PËR VEPRIMTARINE E KËSHILLIT
DREJTUES TË INSTITUTIT TË
EKSPERTËVE KONTABËL TË
AUTORIZUAR PËR VITIN 2019



IEKA - Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Rr. "Elbasanit", Pallati Edil- AL IT, Tiranë, Shqipëri

Email: info@ieka.al

Web: www.ieka.al

Tel: +355 4 2346077

Mob: 0682063069

Tabela e përmbajtjes

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues	1
Misioni, Objektivat, Funkcionet kryesore	4
Raport mbi realizimin e veprimtarive të IEKA	9
Të dhëna mbi Audituesit Ligjorë, Shoqëritë e Auditimit dhe Kandidatët	18
Kualifikimi Vijueshëm i Anëtarëve dhe Edukimi i Kandidatëve	27
Sigurimi dhe Kontrolli i Cilësisë	33
Investigimi dhe Disiplina	35
Publikime	36
Veprimtari me Organizmat Kombëtare	37
Veprimtaritë me Organizmat Ndërkombëtare	39
Struktura Ekzekutive	43
Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare	45
Objektivat për të ardhmen	47

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues

Të dashur kolegë,

Në emrin tim dhe të Këshillit Drejtues, dëshiroj të falenderoj të gjithë bashkëpunëtorët, audituesit ligjorë, stafin ekzekutiv të Institutit, partnerët dhe institucionet që kontribuan në zhvillimin e profesionit të audituesit ligjor gjatë vitit 2019.

Viti 2019 shënon vitin e 22^{-të} të eksperiencës në profesionin e audituesit ligjor, auditimit të pavarur të Pasqyrave Financiare dhe shërbimeve të lidhura në vendin tonë çka dëshmon jetëgjatësinë, profesionalizmin dhe arritjet e profesionit tonë. Përvoja jonë 22 vjeçare ofron një bazë më të qëndrueshme në përballjen e profesionit dhe organizatës sonë profesionale me sfidat e së ardhmes dhe ekzistencën në vijimësi. Gjatë vitit 2019 IEKA ka ndjekur në mënyrë aktive realizimin e misionit të saj për organizimin e profesionit të audituesit ligjor në Shqipëri. Veprimtaritë që po raportojmë për vitin 2019 në pjesën më të madhe të vitit janë kryer nën drejtimin e ish Kryetarit të Këshillit Drejtues z. Hysen Çela, mandati 4 vjeçar i të cilit përfundoi në shtator 2019.

Këshilli Drejtues i zgjedhur në tetor 2019, ka vijuar punën për realizimin e aktiviteteve të

planifikuara sipas programit të miratuar nga KD për këtë vit.

Profesioni i audituesit ligjor në vendin tonë mbart kontributin e të gjithë audituesve ligjorë, nisur nga themelimi i tij në vitin 1997, duke u zhvilluar vit pas viti deri më sot.

Duke kujtuar me respekt të veçantë themeluesin e këtij profesioni në Shqipëri, profesorin tonë të nderuar dhe Kryetarin e parë të Këshillit Drejtues z. Baki Berberi, ndjem i privilegjuar të jem Kryetar i Këshillit Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Profesioni i audituesit ligjor gjendet përballë kërkesave të shtuara rregullatore, të cilat kanë qenë dhe janë evidente në mbarë globin.

Ndikimi i mjedisit të biznesit dhe rregullatorëve në vend edhe gjatë vitit 2019 kanë përballur audituesit ligjorë me sfida të shumta, të cilat nuk kanë qenë të lehta për tu menaxhuar. Megjithatë organizata jonë profesionale është përpjekur t'i përballojë sfidat duke evidentuar me kujdes problematikat në shumë aspekte të zhvillimit të profesionit e në mënyrë të veçantë në fushën e edukimit dhe cilësisë.

Sfidat e ndryshme që kanë shoqëruar profesionin e audituesit ligjor nga njëra anë dhe rritja e kërkesave rregullatore nga ana tjetër kanë vënë në vështirësi audituesit ligjorë e sidomos ata individë që e ushtrojnë profesionin si persona fizikë ose në shoqëri auditimi të vogla.

Në vitin 2019 është rritur rreth 11% shuma e auditimeve ligjore, rreth 13% shuma e angazhimeve të tjera krahasuar me vitin 2018.

Gjithashtu është rritur ndjeshëm numri i Njësive Ekonomike me Interes Publik si rezultat i hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17 datë 16.01.2019, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”.

Shtimi i numrit të entiteteve me interes publik sipas kësaj VKM, e ka vënë organizmin tonë profesional para sfidave të mëdha, për shkak se janë rritur kërkesat ligjore rregullatore të detyrimeve të raportimit për audituesit ligjorë, duke ndikuar në rritjen e honorareve të auditimit, të cilat krijojnë kosto shtesë për biznesin.

Konstatimet dhe propozimet tona në lidhje me përkufizimin e entiteteve me interes publik, i janë adresuar Ministrit të Financave dhe aktorëve të tjerë në vend. Në bashkëpunim me grupet e interesit, IEKA ka vijuar përpjekjet për ndryshimin e VKM.

Organizata profesionale e audituesve ligjorë IEKA, nisur edhe nga eksperiencia e organizmave

profesionale anëtare si IFAC, FCM, EFAA, etj, ka përmirësuar procedurën e auditimit për Njësitë e Vogla dhe të Mesme me qëllim rritjen e cilësisë së punës së audituesve. Bazuar në këtë eksperiencë IEKA në vazhdimësi synon të përmirësojë procesin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve për tju përgjigjur më mirë kërkesave në rritje.

Edhe gjatë vitit 2019, IEKA nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj ka dhënë kontribut në tryeza diskutimi mbi zhvillimin e profesionit, raportimin financiar, legjislacionin fiskal, etj.

Kontributi dhe vlerësimi i organizatës tonë profesionale gjatë vitit 2019 është evidentuar edhe me pjesëmarrjen në Grupin Këshillimor Konsultativ (CAG) të Bordeve të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe atë të Etikës pranë IFAC (respektivisht IAASB dhe IESBA).

Me këtë rast dëshiroj të falenderoj Kryetarin dhe Këshillin Drejtues të IEKAs që përfundoi mandatin në 30 shtator 2019, për kontributin në profesionin e audituesit ligjor dhe vlerësimin që organizata jonë profesionale ka marrë nga organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Falenderoj gjithashtu edhe Drejtoreshën Ekzekutive të IEKAs dhe stafin ekzekutiv për punën dhe përkushtimin në menaxhimin e suksesshëm të aktiviteteve profesionale të organizatës tonë gjatë vitit 2019.

Ju falenderoj ju të nderuar kolegë auditues ligjorë për kontributin, arritjet, vlerësimin dhe besimin në profesionin e audituesit ligjor dhe tek organizata jonë profesionale IEKA.

Të nderuar kolegë auditues ligjorë, ju me eksperiencë që nga krijimi i profesionit si dhe ju anëtarët më të rinj, të gjithë së bashku jemi tashmë krenarë për arritjet në profesionin e audituesit ligjor!

Ne kemi arritur të përkthejmë dhe publikojmë versionet e përditësuar të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, të Kodit të Etikës së IAASB, të kemi në përdorim një software auditimi të njohur ndërkombëtarisht si Caseware Working Paper, të jemi faktorë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar në vendin tonë, si dhe të ofrojmë një sistem bashkëkohor të edukimit të kandidatëve.

Shpreh bindjen dhe besimin, se profesioni i audituesit ligjor dhe organizata jonë profesionale e krijuar dhe zhvilluar me profesionalizëm dhe integritet do të dijë të përballojë sfidat dhe vështirësitë, të cilat janë të pashmangshme në rrugën e zhvillimit.

Që prej fillimit të muajit mars 2020 ne jemi duke u përballur me një pandemi globale që ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën sesi ne po

jetojmë dhe punojmë, e cila ka pasur pasojat më të rënda ekonomike se çdo ngjarje tjetër që nga Lufta e Dytë Botërore. Ne po jetojmë në kohë të pashembullt, ku jeta jonë personale dhe profesionale është duke ndryshuar.

Shoqëritë tregtare kërkojnë një zgjidhje të shpejtë, të sigurtë e me kosto sa më të ulët. Profesionin ynë në përpjekje për të mbijetuar dhe për tu zhvilluar, duhet të përmbushë këto kërkesa me profesionalizëm dhe kompetencë.

Ky është detyrimi ynë profesional dhe besoj se ne audituesit ligjorë dhe organizata jonë profesionale do ta përmbushim mirë këtë detyrim.

Në këtë vit të pazakontë për mbarë globin tonë Ju uroj të gjithë audituesve ligjorë:

Të gëzoni shëndet të mirë Ju dhe familjarët e bashkëpunëtorët tuaj!

Me vlerësim e konsideratë,

Berti Pashko

Kryetar i Këshillit Drejtues të IEKAs

Misioni, Objektivat, FunkSIONET kryesore

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) u krijua më datën 24 Nëntor 1997, me statusin e një organizate profesionale jo fitimprurëse, që grupon profesionistët kontabël të pajisur me titullin "Auditues Ligjor" (titull i ndryshuar në vitin 2016), të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në praktikë:

- në mënyrë individuale, si person fizik
- si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese
- si i punësuar tek një tjetër auditues ligjor i regjistruar

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka për objekt të veprimtarisë së tij të sigurojë

ushtimin e profesionit të audituesve ligjorë në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij. **Misioni** i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) është të rregullojë organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara të shoqërive tregtare në zbatim të ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar me ligjin 47/2016.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

Objektivat strategjike nga të cilat udhëhiqet IEKA, në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, janë:



Të sigurojë ushtimin e profesionit të Audituesit ligjor në përputhje me ligjin



Të mbështesë respektimin e pavarësisë së anëtarëve të IEKA-s



Të garantojë mbikëqyrjen e formimit profesional të Audituesve Ligjorë

 Të sigurojë ushtrimin e profesionit të Audituesit ligjor në përputhje me ligjin	 Të mbështesë respektimin e pavarësisë së anëtarëve të IEKA-s	 Të garantojë mbikëqyrjen e formimit profesional të Audituesve Ligjorë
 Të rritë njohjen dhe zbatimin në praktikë të standardeve me cilësi të lartë në të njëjtën linjë me zhvillimet ndërkombëtare	 Të përmirësojë në vijimësi shërbimet në interes të publikut.	 Të kontribuojë dhe promovojë në zhvillimin, adaptimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare me cilësi të lartë

Për të siguruar një vazhdimësi të profesionit të Audituesit Ligjor, Instituti synon të mbështetet në modele dhe eksperiencë të përparuara duke kombinuar përmirësimin e legjislacionit me edukimin e anëtarëve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve profesionale cilësore nga trajnerë me përvojën më të mirë vendase dhe të huaj.

Sipas Ligjit të Auditimit, **Këshilli Drejtues i IEKAs** kryen drejtimin e veprimtarisë së Institutit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me statutin, si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Këshilli Drejtues, ka përbërjen e mëposhtme:

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Berti PASHKO | Kryetar |
| 2. Arqile MISHTAKU | Zv/Kryetar |
| 3. Bujar OSMANI | Anëtar |
| 4. Shkëlzen MARGJEKA | Anëtar |
| 5. Rezarta KOÇOLLARI | Anëtar |
| 6. Elton TIRANA | Anëtar |
| 7. Arian CYRBJA | Anëtar |



Organet Drejtuese të IEKAs (Tetor 2019)

Këshilli Drejtues i IEKAs përbëhet nga 7 anëtarë. Katër anëtarë janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2023 dhe tre anëtarët e tjerë janë zgjedhur me short me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2021.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 1 tetor 2019 ka zgjedhur Kryetarin dhe zv/Kryetarin e tij dhe në 9 tetor 2020 Këshilli u riformatua duke zgjedhur Kryetar z. Berti Pashko dhe anëtar z. Arian Cyrbja.

Drejtori Ekzekutiv është riemëruar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 43 datë 20.09.2017.

Gjatë vitit 2019 Këshilli Drejtues ka realizuar 12 mbledhje dhe ka marrë gjithsej 58 vendime.

Këshilli Drejtues ka kompetencë miratimin e vendimeve, hartimin e akteve nënligjore, të cilat i dërgohen për miratim Asamblesë së Përgjithshme ose sipas rastit edhe Bordit të Mbiqyrjes Publike, hartimin e kurrikulave të përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për kandidatët, organizimin e kontrollit të cilësisë, etj. Në muajin maj 2019 Këshilli Drejtues ka miratuar Programin e Punës për vitin 2019.

Këshilli Drejtues harton buxhetin e organizatës profesionale IEKA, vendos për politikat e administrimit dhe për procedurat e përdorimit

të mjeteve financiare dhe realizimin e veprimtarisë së tij. Në maj 2019, Këshilli Drejtues miratoi buxhetin vjetor 2020, i cili u miratua në Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve në muajin qershor të 2019. Buxheti vjetor u hartua në përputhje me parashikimet e zhvillimeve të ardhshme sipas sektorëve në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2020.

Objektivat kryesore që udhëhoqën hartimin e buxhetit vjetor 2020, synuan funksionimin normal të veprimtarisë së IEKAs, ruajtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimin e shërbimeve të detyrueshme për anëtarët/kandidatët, etj.

Këshilli Drejtues është informuar nga kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm për sigurimin e respektimit të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar, auditimin e Pasqyrave Financiare vjetore, si edhe përputhshmërinë e veprimtarisë së IEKAs me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm përbëhet nga dy anëtarë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve më datë 30 shtator 2019:

1. Elida Miti
2. Sokol Toska

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm kontrollon veprimtarinë financiare të Institutit, mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin, si dhe rregullsinë dhe korrektësinë e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

Në statut është parashikuar që pasqyrat financiare të Institutit do të auditohen nga një auditues ligjor, i cili propozohet nga Komiteti i i Kontrollit të Brendshëm.

Këshilli Drejtues është informuar nga Drejtori Ekzekutiv për realizimin e veprimtarive dhe realizimin e buxhetit në afatet kohore të parashikuara në statut.

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies ndaj anëtarësisë duke hartuar këtë raport vjetor, pjesë përbërëse të të cilit janë edhe pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë audituar nga audituesit ligjor:

- Rajmonda Reveli
- Shoqëria e auditimit TPA Albania, audituese ligjore Laura Gjinali.

Sipas opinionit të audituesve ligjorë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKAs më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë në përputhje me politikat e përshtatura nga Këshilli Drejtues, të cilat janë bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanërisht në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF.

IEKA është anëtare me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare në vijim:

IEKA anëtare në organizatat Ndërkombëtare

IFAC - Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve



FIDEF - Federata e Ekspertëve Kontabël Frankofonë,



FCM - Federata e Ekspertëve Kontabël të Mesdheut



EFAA - Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Audituesve të Entiteteve të Vogla dhe të Mesme



CFRR - Qendra për Reformën e Raportimit Financiar në të cilën IEKA është pjesëmarrëse aktive në programet e edukimit kontabël dhe të auditimit



RAPORT MBI REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE TË IEKA

Të nderuar anëtarë,

Në përmbushje të detyrimeve tona ligjore për transparencë dhe llogaridhënie, Raporti Vjetor i veprimtarisë së Këshillit Drejtues përshkruan aktivitetet e IEKAs për vitin 2019, i cili synon të prezantojë, në tërësi dhe me vërtetësi punën e bërë dhe rezultatet e arritura gjatë një viti.

Si institucioni që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e profesionit të audituesit ligjor, IEKA është përgjegjëse për programin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve, hartimin e kurrikulave dhe programin e përgatitjes profesionale të kandidatëve, organizimin e sistemit të kontrollit të cilësisë së punës së anëtarëve, investigimin në rastet e shkeljeve të standardeve teknike dhe të etikës profesionale, si edhe sigurimin se anëtarët e saj zbatojnë praktikën më të mirë në fushën e standardeve profesionale dhe të etikës.

Më lejoni të theksoj, që në fillim të këtij komunikimi, se gjatë vitit 2019, Këshilli Drejtues i IEKAs ka punuar me përkushtim dhe profesionalizëm për përmbushjen e misionit dhe detyrave ligjore, edhe pse sfidat nuk kanë munguar përgjatë 2019 dhe vazhdojnë të jenë të mëdha edhe gjatë vitit 2020.

Raporti i Veprimtarisë Vjetore 2019 i Këshillit Drejtues të IEKAs, hartohet në rrethana shumë të ndryshme nga ato të një viti më parë. Sfidat kryesore që prej shpërthimit të pandemisë COVID-19 ishte përshtatja me realitetin e ri dhe adresimi i efekteve në auditimin ligjor dhe shërbimet e tjera, situatë në të cilën Këshilli Drejtues mori disa masa për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit të Institutit IEKA si dhe funksionimin e profesionit të audituesit ligjor.

Pandemia Covid-19 shkaktoi një goditje të fortë jo vetëm mbi ekonominë, por edhe mbi profesionin e audituesit ligjor. Për këtë arsye, në këtë raport do të trajtohen jo vetëm drejtimet dhe rezultatet kryesore të punës së Këshillit Drejtues gjatë vitit 2019, por edhe në kontekstin aktual dhe pritjet tona për të ardhmen.

Mesazhi ynë kryesor është se profesioni i audituesit ligjor i ka premisat ta përballojë këtë sfidë të vështirë, duke kontribuar në rimëkëmbjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në këtë raport, do të evidentohen si arritjet ashtu edhe problemet dhe sfidat me të cilat është përballuar KD gjatë kryerjes së rolit të tij të drejtimit dhe qeverisjes midis dy mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Siç tashmë ju e dini, 2019 ishte një vit zgjedhor për Këshillin Drejtues dhe Komitetin e Kontrollit të Brendshëm. Në asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve të muajit shtator 2019, u zgjodhën katër anëtarë të Këshillit Drejtues që do të kenë mandatin e tyre për një periudhë 4-vjeçare. Vijimësia në organet drejtuese u bë e mundur për arsye se tre nga anëtarët e Këshillit Drejtues përfituan zgjatje mandati për një periudhë 2-vjeçare. Në mbledhjen e parë të Këshillit të Ri Drejtues, në datën 1 tetor 2019 u zgjodh Kryetari i Këshillit Drejtues zj. Eleonora Olli dhe Zv/Kryetari i Këshillit Drejtues z. Arqile Mishtaku.

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2019, në funksion të forcimit të integritetit të Institutit IEKA, por edhe të rritjes së kapaciteteve të tij ndërmori një sërë hapash të rëndësishëm për profesionin e Audituesit Ligjor, ndër të cilat mund të përmendim:

- Analizën e VKM nr.17 datë 16.01.2019, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”, bazuar në kriteret e vlerësimit.

Sipas kësaj analize, rritja e konsiderueshme e numrit të shoqërive me interes publik u konsiderua se do të kishte pasoja dhe ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së biznesit, si dhe në tejkalim të kërkesave ligjore dhe frymës së dokumentave bazë që rregullojnë veprimtarinë e audituesve ligjorë në vendin tonë:

- (i) Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar - neni 2, pika 23, gërma ç;
- (ii) Direktivës së Auditimit ligjor (2006/43/EC of the European Parliament and of the Council) - neni 2, pika 13, gërma d; si edhe
- (iii) Kodit të Etikës për profesionistët kontabël të IAESB të IFAC [International Independence Standards (Parts 4a and 4b)] - paragrafi 400.8

IEKA ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ndryshimin e VKM nr.17 datë 16.01.2019 nëpërmjet dërgimit të shkresave zyrtare dhe takimeve të realizuara në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Këto përpjekje u finalizuan me dërgimin e propozimit final në janar 2020 për ndryshimin e VKM-së, propozim i cili u përgatit nga IEKA në bashkëpunim me 6 shoqëri të mëdha audituese.

- Miratimin e Aneksit të “Audituesve Ligjorë të ç’regjistruar nga regjistri publik, të cilët vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin pranë një shoqërie auditimi” bazuar në nenin 26, pika 2 e Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar) dhe publikimin në një Aneks të veçantë të Listës së Audituesve Ligjorë, të cilët nuk e ushtrojnë aktivitetin për arsye se kanë mbushur moshën 65 vjeç.
- Miratimin e Rregullores së studimeve Post-Master për kandidatët që kryejnë praktikën profesionale për Auditues Ligjorë. Kjo rregullore bën të mundur zbatimin e programit të përgatitjes profesionale sipas kurrikulës së re të profesionit të Audituesit Ligjor.
- Miratimin e Rregullave “Për organizimin e shortit për përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Drejtues”, që do të vazhdojnë mandatin e anëtarit të Këshillit Drejtues edhe për dy vitet e ardhshme: tetor 2019 - tetor 2021.
- Përpjekje për të ndryshuar aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (rregulloret), për të cilat është evidentuar mospërputhshmëri ligjore. Këshilli Drejtues i ka kërkuar Ministres së Financave dhe Ekonomisë (MFE), si autoriteti që emëron anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike të shprehet lidhur me pajtueshmërinë ligjore të këtyre rregulloreve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë urdhëroi ngritjen e një grupi pune për të bërë rishikimin e Rregulloreve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike në 22 korrik 2019. Në Raportin e Grupit të Punës të Ministrisë u evidentuan gjetje në lidhje me mospërputhshmërinë ligjore të akteve nënligjore të miratuara nga BMP (rregulloreve), për të cilat Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka kërkuar Bordit të Mbikëqyrjes Publike të marrë në konsideratë gjetjet dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raport nga grupi i punës brenda 30 ditësh nga shkresa e MFE datë 20.09.2019 nr. Prot 13896/1.
- Përpjekje për marrjen e delegimit nga BMP të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike, të cilat nuk janë me interes publik në përputhje me nenin 39 të ligjit të auditimit. Në të gjitha komunikimet me Bordin, IEKA ka argumentuar se ka patur dhe vijon të ketë në funksionim një sistem efikas të kontrollit të cilësisë dhe do të angazhojë individë që përmbushin kriteret e kërkuara, duke garantuar realizimin me sukses të tij.

- Përfitim i software-it të auditimit Caseware Working Paper, në kuadër të projektit kombëtar “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar (REPARIS). IEKA ka qenë përfitues i komponentit të projektit “Support IEKA members to increase capacity and knowledge on ISAs application through training programs, including tools and methodologies”. Ky komponent i projektit u financua nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), u administrua nga Banka Botërore dhe u ekzekutua nga Ministria Financave dhe Ekonomisë. Projekti ka filluar me nënshkrimin e kontratës në vitin 2017. Pas dakordësimit të termave të referencës është realizuar trajnimi i audituesve ligjorë me standardet ndërkombëtare të auditimit. Referuar aktiviteteve 3.3.1 “Identifikimi i programit kompjuterik të auditimit” me ndihmesën e konsulentit të projektit të shoqërisë së auditimit Grant Thornton Albania, pas analizës krahasuese, u realizua përzgjedhja e një programi kompjuterik auditimi Caseware (Canada), i cili është një program auditimi i njohur në tregun evropian dhe ofron një platformë gjithëpërfshirëse në ndihmë të procedurave të auditimit. Shoqëritë audituese/personat fizikë që shprehën interesin, përfituan pa pagesë licensën për përdorimin e programit dhe moduleve të Caseware Working Paper për tre modulet (CaseWare Working Papers + Audit International + Smart Sync) për dy vitet e para. Në kuadër të projektit u realizua trajnimi i audituesve ligjorë nga konsulenti i projektit për përdorimin e këtij programi me raste praktike, prezantimi i Programit dhe Moduleve të Caseware WP i një Rasti Studimor si dhe auditimi sipas SNA-ve.
- Veprimtaritë e KD edhe gjatë 2019 adresuan çështjet më të rëndësishme profesionale, përmirësuan komunikimin e informacioneve për anëtarët duke i pajisur ata me shumë udhëzime dhe materiale të vlefshme dhe në dobi të rritjes së cilësisë së punës. Në zhvillimin profesional të vijueshëm, vëmendja ju kushtua nevojave që anëtarët kanë për më shumë njohuri në lidhje me zbatimin e standardeve teknike të fushës kontabël dhe të auditimit, të etikës profesionale, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit, të kontabilitetit e raportimit financiar përfshirë përmirësimet në kodin e etikës dhe çështjet e aktualizimit të njohurive në fushën e tatimeve dhe taksave, u trajtuan gjerësisht gjatë dy sesioneve të kualifikimit të vijueshëm.

Shërbimet profesionale të dhënies së sigurisë, e në mënyrë të veçantë auditimi i detyrueshëm i informacioneve financiare historike, gjenden sot përballë situatave ku presioni është gjithnjë e më shumë i pranishëm. Autoritetet rregullatore në shumë vende përfshirë edhe vendin tonë po bëjnë ndryshime esenciale me qëllim zvogëlimin e barrës dhe të kostove shtesë për biznesin. Këto autoritete po i paraqesin ligjvënësve të tyre kërkesa dhe propozime për ndryshime, rishikime dhe përmirësime të mëdha, jo vetëm në edukimin bazë, por edhe në drejtim të standardeve teknike, profesionale dhe në procedurat e punës. Të gjendur përpara këtyre ndryshimeve, profesioni i

audituesit ligjor duket se po i orienton përpjekjet e tij në zgjerimin e gamës së shërbimeve shtesë nga njëra anë dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve nga ana tjetër.



Gjatë vitit 2019, numri i anëtarëve të IEKAs ka patur një rritje prej 6.7% në krahasim me nivelet e vitit të kaluar (2018). Në fund të vitit 2019, në Regjistrin publik të AL ishin të regjistruar 222 AL dhe 63 shoqëri auditimi (firma auditimi).

Në zbatim të programit të punës të miratuar, edhe gjatë këtij viti Këshilli Drejtues vijoi të bëjë përmirësime në aktet rregullatore dhe profesionale me qëllim zbatimin e duhur dhe eficient të tyre, çka tregon për një zhvillim profesional dinamik që mban parasysh jo thjesht nevojat e anëtarësisë, por edhe reagimin e duhur ndaj tyre. Veprimtaritë trajnuese të anëtarëve u plotësuan me botime të reja profesionale të IFAC-ut për të mbuluar zhvillimet e reja, përmirësimet në standardet e auditimit, standardet për shërbimet e rishikimit, të sigurive të tjera, të kontrollit të cilësisë, shërbimet e lidhura, etj.

Gjatë vitit 2019, vijoi puna për përkthimin në gjuhën shqipe dhe përditësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB). Me qëllim mbajtjen sa më të informuar dhe aktualizimin me ndryshimet më të fundit në standardet e auditimit, në datë 18 Shtator 2019 këto standarde janë vënë në dispozicion të anëtarëve dhe të kandidatëve për Auditues Ligjor të IEKAs nëpërmjet adresave të postës elektronike e-mail.

Këto standarde janë publikuar në faqen e web-it të IEKAs, në rubrikën Standardet Profesionale, sipas Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurimeve të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura.

Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare, botimi i vitit 2018, përmbledh paketën e plotë të Deklaratave të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit e Sigurisë, të Standardeve mbi Kontrollin e Cilësisë, Auditimin, Rishikimin, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, si dhe Direktivën jo Detyruese të Praktikave Ndërkombëtare të Auditimit. Manuali, së bashku me ndryshimet nga amendimet konformuese përkatëse ka të përfshirë në të edhe standardet e rishikuara si më poshtë:

		
SNA 250 (i rishikuar) - Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare SNA 260 (i rishikuar) - Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen SNA 315 (i rishikuar) - Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij SNA 540 (i rishikuar) - Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatese Shpjeguese SNA 570 (i rishikuar) - Vijmësia SNA 610 (i rishikuar) - Përdorimi i Punës së Audituesve të Brendshëm SNA 800 (i rishikuar) - Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Përgatitura në Përputhje me Kuadrot për Qëllime të Veçanta SNA 805 (i rishikuar) - Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare SNA 810 (i rishikuar) - Angazhimet për Raportimin mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura	Gjatë vitit 2019 Instituti ka vijuar punën duke përkthyer dhe rishikuar në gjuhën Shqipe, Volumnin e tretë të IAASB-së, Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura. <u>Volumi III i këtij Manuali përfshin:</u> 1. Kuadrin e IAASB për Cilësinë e Auditimit: Elementët kryesore që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit; dhe 2. Kuadrin Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë. Kuadri i IAASB për Cilësinë e Auditimit, <i>Elementët kryesore që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit</i>, është një nga temat e rëndësishme, me fokus kyç për IAASB. Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë, përcakton parimet të një niveli të lartë të zbatueshme për të gjitha angazhimet e sigurisë	Gjithashtu gjatë vitit 2019 IEKA është përkthyer volumi i ri dhe i ristrukturuar i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët, ose siç njihet gjerësisht, Kodi IESBA. Kryetari i BSNEK-së, Dr. Stavros Thomadakis ka theksuar se “Ky është një moment revolucionar në shërbim të interesit publik. Kodi tani është një platformë e forcuar ndjeshëm, ai është ri- dizajnuar për përdorim më të gjerë, duke ruajtur zbatueshmërinë globale. Kodi thekson rëndësinë e parimeve themelore për të gjithë profesionistët kontabël. Tashmë fillon puna kritike brenda firmave, organeve të hartimit të standardeve, rregullatorëve dhe organeve të mbikëqyrjes së auditimit, organizatave të edukimit, organizatave anëtare të FNK-së dhe të tjerëve, në vetëdijësimin mbi Kodin dhe në mbështetje të adoptimit dhe zbatimit të tij”.

Një vëmendje e veçantë, ndër të tjera i është kushtuar Standardit Ndërkombëtar të Auditimit - SNA 540 (i rishikuar) "Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatëse Shpjeguese", i cili hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më datë 15 Dhjetor 2019 dhe pas kësaj date. Në mbështetje të anëtarëve për t'i ndihmuar në përdorimin dhe zbatimin e këtij standardi, IEKA ka publikuar në faqen e web materiale të ndryshme udhëzuese dhe informuese të marra nga IFAC. SNA 540 (i rishikuar) ka në objektivin e vetë përgjegjësitë e audituesit në lidhje me çmuarjet kontabël dhe informacionet përkatëse shpjeguese në auditimin e pasqyrave financiare.

Të dy volumet e Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare (Volumi I dhe III) u publikuan gjatë vitit 2020 në faqen e web-it të IEKAs, si dhe u shpërndanë për të gjithë anëtarët në adresat e postës elektronike e-mail. Gjatë vitit 2020 është duke vazhduar puna për përkthimin e Volumit të II të Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS/IAASB).

Kontrolli i zbatimit të kërkesave të SNA-ve vazhdon të mbetet një nga objektivat kryesore të punës së IEKAs. Për këtë qëllim duhet të përdoren më mirë se deri më sot, instrumentet e kontrollit të cilësisë, pasi ato të na autorizohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe të hartohen e zbatohen rregulla të veçanta për kontrollin e zbatimit të parimeve etike e kërkesat e pavarësisë, duke i lidhur papajtueshmëritë kur ato janë rëndësishme edhe me procedurat e investigimit dhe të disiplinës së brendshme të IEKAs. Përcaktimi i

një serie masash të brendshme do të ndihmonte shumë në këtë drejtim.

Duke qenë se në vitin 2019, angazhimet e tjera zënë rreth 55% të totalit të angazhimeve të kryera nga audituesit ligjorë, kontrolli i cilësisë së punës së shërbimeve të tjera mbetet një nga objektivat që IEKA duhet të arrijë në periudhën në vijim.

Konteksti ekonomik global dhe vendas gjatë vitit 2019 ishte kompleks dhe me sfida të shumta, përfshirë kërkesat rregullatore në rritje ashtu edhe problemet me të cilat është përballur ekonomia shqiptare gjatë vitit 2019 e në vazhdim. IEKA ka qenë prezente në takime me institucionet qendrore dhe lokale duke dhënë kontributin e saj nëpërmjet dhënies së mendimeve për disa projektligje të propozuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe institucioneve të tjera. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka punuar me seriozitet dhe përkushtim për përmbushjen e detyrave dhe angazhimeve të tjera institucionale të tij.

Nisur nga praktikat e shumë vendeve të BE-së dhe atyre aspirante, roli i Bordit të Mbikëqyrjes Publike në një të ardhme të afërt duhet fokusohet direkt dhe vetëm në kontrollin e cilësisë, të audituesve dhe auditimeve të entiteteve me interes publik, siç janë Bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe të ri-sigurimit, si dhe një numër ndërmarrjesh të mëdha, me pronësi shtetërore dhe/ose private, që janë përcaktuar nga qeveria si entitete me interes publik. Pra, pavarësisht këtyre zhvillimeve, të inicuar për të qenë në pajtim me kërkesat e Direktivës Europiane të Auditimit

Ligjor (EU SAD), IEKA do të vijojë të bëjë përpjekje që roli i saj të mbetet ai i njërit prej autoriteteve rregullatore kompetente të profesionit, me qëllim që të ketë rol e përgjegjësi në çështje të tilla si kontrolli i cilësisë, investigimi, edukimi i kandidatëve dhe anëtarëve, përgatitja e udhëzuesve dhe procedurave të punës profesionale, etj. Raportet midis IEKAs dhe BMP janë e do të jenë në evoluim të vazhdueshëm dhe do të kushtëzohen gjithmonë me zhvillimet që mund të ndodhin në mjedisin European dhe me hapat integruese që do të bëjë vendi ynë në vitet e ardhshme.

Në vitin 2019 IEKA ka përmirësuar procesin e edukimit dhe përkthimin e teksteve të ACCA (Kaplan Publishing) që janë përdorur si module të përgatitjes së profesionistëve në vendin tonë.

Gjatë vitit që kaloi Instituti realizoi me sukses fillimin e procesit të edukimit profesional të kandidatëve sipas kurrikulës së re të miratuar për profesionin e audituesit ligjor. Për herë të parë nisi Trajnimi i kandidatëve të vitit të parë me modulën profesionale (niveli i avancuar) në lëndën **“Raportimi Financiar i Avancuar”**. Vazhdimi i trajnimit me këtë modul u realizua në vitin 2020. Gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, kandidatët për auditues ligjorë do të trajnohen me modulet si vijon:

- Tatime dhe taksa – Nivel i Avancuar
- Legjislacioni i Avancuar
- Drejtimi i Performancës i Avancuar
- Auditim & Dhënie Sigurie – Nivel i Avancuar
- Etika Profesionale

Ndryshimet që kanë pasuar miratimin e kurrikulës së plotë të audituesit ligjor dhe veçanërisht inicimi i shkollës postmaster të IEKAs, tregon se ky proces është në rrugën e një përmirësimi të vazhdueshëm.

Versionet më të fundit të materialeve të ACCA-së janë ato të vitit 2019-2020, të cilat tashmë janë aksesuar nga IEKA dhe po punohet që këto materiale t'i vihen në dispozicion kandidatëve aktualë për Auditues Ligjor që ndjekin praktikën profesionale. Aktualisht është përkthyer nga libri i ACCA “Raportimi financiar”, moduli i parë i trajnimeve për kandidatët për Auditues Ligjor, që përfshin tema të tilla si: aktivet, kurset e këmbimit, qiraja financiare, ngjarjet pas datës së bilancit, etj dhe ka përfundur përkthimi i modulit të dytë. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që kandidatët për Auditues Ligjor në Shqipëri të përgatiten në të njëjtën mënyrë si të gjithë kandidatët e tjerë në të gjithë botën. Megjithatë mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të monitorimit të praktikës profesionale dhe garantimit të një udhëheqje profesionale dhe cilësore.

Lidhur me kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve, Instituti ka treguar shumë kujdes në përzgjedhjen e temave të duhura dhe angazhimin e lektorëve të kualifikuar. Organizimi i trajnimeve në grupe më të vogla, është një nga objektivat që Instituti pritet të realizojë në të ardhmen. Në kushtet e zbatimit të masave të rekomanduara nga Qeveria Shqiptare për ruajtjen e distancimit social, si dhe duke respektuar masat e sigurisë për kufizimin e transmetimit të COVID-19, mori një rëndësi të veçantë organizimi i trajnimeve

online. Kjo formë trajnimi është e rekomanduar edhe nga IFAC dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, në të cilat IEKA është e anëtare me të drejta të plota.

Megjithë rolin e rëndësishëm të IEKAs dhe të anëtarëve të saj për përmirësimin e raportimit financiar në vendin tonë, ka nevojë për përmirësim në drejtim të cilësisë së shërbimeve profesionale, të respektimit të procedurave të parashikuara në standardet e auditimit, të raporteve të auditimit dhe të sigurive të tjera, respektimit të Kodit të Etikës, të rotacionit të audituesve pas përfundimit të periudhës kufi të përcaktuar nga ligji i auditimit, të vlerësimit të konflikteve të interesit nga dhënia e shërbimeve të tjera si kontabilitet, këshillime fiskale për të njëjtin klient auditimi, përdorimi i tarifave të ulëta në auditim, mosdeklarimi i misionëve dhe moslikuidimi në kohë i kuotave profesionale, etj.

Faqa e internetit të IEKAs vazhdon të pasurohet në mënyrë aktive me materiale të dobishme për audituesit ligjorë. Gjatë këtij viti është publikuar edhe Kodi i ri i Etikës dhe tools-et eCode, të cilat do t'ju vijnë në ndihmë anëtarëve të IEKAs gjatë përdorimit të Kodit të Etikës. Një faqe e re web-i, e cila do të jetë më interaktive dhe profesionale, është në proces përgatitje. Regjistri Publik i Audituesve Ligjor, aktualisht është lehtësisht i aksesueshëm për përdoruesit aktualë dhe potencial dhe është i

publikuar në faqet e institucioneve të rëndësishme kombëtare si: QKR, Gjykatat, etj.

Gjatë vitit 2019, u konsoliduan marrëdhëniet institucionale të IEKAs me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e të Sipërmarrjes, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj.

Zhvillime të reja dhe konsolidim njohën edhe marrëdhëniet e IEKAs në sferën ndërkombëtare, me organizata të tilla si IFAC, FCM, FIDEF, EFAA, Banka Botërore, CFREP Reparis - Vienë, ACCA, FEE, etj.

Rritja e rolit dhe përmirësimi i reputacionit të Audituesit Ligjor dhe të organizatës sonë profesionale mund të bëhet realitet vetëm nëse ne do të kombinojmë më mirë se deri më sot rolin e organeve të zgjedhura me ato ekzekutive, nëse mendojmë seriozisht për investime afatgjata në burimet njerëzore, me synim fuqizimin administratës ekzekutive, në funksion të përmirësimit të qeverisjes së Institutit dhe rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Vetëm në këtë mënyrë nga njëra anë interesi publik trajtohet me prioritet dhe nga ana tjetër mbrohet nderi dhe reputacioni i individit.



Të dhëna mbi Audituesit Ligjorë, Shoqëritë e Auditimit dhe Kandidatët

Nga të dhënat e Regjistrimit Publik të IEKAs, në fund të vitit 2019 rezultojnë të regjistruar 222 Auditues Ligjorë, nga të cilët 125 femra (56.3%) dhe 97 meshkuj (43.7%), si dhe 63 shoqëri audituese.



125 femra

97 meshkuj


Gjatë vitit 2019 ka rezultuar se janë çregjistruar në mënyrë definitive 6 Auditues Ligjorë për shkak se mbushën moshën e daljes në pension dhe 2 auditues ligjorë për shkak se ndërruan jetë.

Të regjistruar në Regjistrin Publik edhe për vitin 2019 vijnë të jenë 4 auditues ligjorë me titullin CPA (të marrë në SHBA) dhe 16 auditues ligjorë të pajisur me titullin ACCA.

Për vitin 2019, përbërja e anëtarëve të organizatës profesionale vijon të jetë si më poshtë:

- 137 AL e ushtrojnë profesionin si persona fizikë, nga të cilët 80 femra dhe 57 meshkuj;
- 84 AL janë të angazhuar në shoqëri auditimi, nga të cilët 44 femra dhe 40 meshkuj; dhe
- 1 AL e ushtron profesionin si i punësuar te një tjetër Auditues Ligjor i regjistruar.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike ushtrimi i profesionit nga audituesit ligjorë deri në datë 31.12.2019:




Sipas nenit 32, pika 2 e Ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Audituesi Ligjor mund ta ushtrojë profesionin:

1. në mënyrë individuale;
2. si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese;
3. i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.



Nga 63 shoqëri auditimi rezulton se:

- 68 % ose 43 shoqëri auditimi ose janë vetëm me një Partner Angazhimi /Auditues Ligjor;
- 21% ose 13 shoqëri auditimi janë me dy partnerë;
- 8% ose 5 shoqëri auditimi janë me tre partnerë auditimi;
- 3% ose 2 shoqëri auditimi nuk kanë pasur Auditues Ligjor.

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike ushtrimi i profesionit në shoqëri auditimi sipas partnerëve të angazhimit/ortakëve deri në datë 31.12.2019:



Në grafikët në vijim paraqiten shpërndarjet e grupmoshave përbërëse të anëtarësisë së Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar:



Gjatë vitit 2019 krahasuar me të dhënat e vitit 2018, vihet re:

- rritje e audituesve ligjorë në grupmoshat:
 1. < 30 vjeç;
 2. 31-40 vjeç;
 3. 41-50 vjeç
 4. >60 vjeç,
- rënie në grupmoshën 51-60 vjeç.

Në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjore të IEKAs, krahas katër firmave më të mëdha audituese:

- Deloitte
- KPMG (çregjistruar në 2020)
- PricewaterhouseCoopers
- Ernst & Young


rezultojnë të regjistruar edhe degë apo përfaqësues të firmave pjesë e rrjeteve ndërkombëtare të tilla si:

- BDO, Baker Tilly, Crowe, Ficadex, Grant Thornton, Kreston,
- Mazars, Moore Stephens, Russel Bedford, RSM, TPA, UHY.

Në objektin e veprimtarisë së këtyre shoqërive përfshihet auditimi ligjor i pasqyrave financiare të njësive ekonomike, institucioneve financiare bankare dhe jo bankare, sipas kërkesave të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar). Kryesisht në secilën nga këto shoqëri ushtrojnë profesionin 2 deri në 3 Auditues Ligjorë, të regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs.

Audituesit Ligjorë (AL) janë të përqëndruar kryesisht në Tiranë, por duhet theksuar se në Regjistrin Publik të IEKAs janë të regjistruar profesionistë nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Shpërndarja gjeografike e audituesve ligjorë, ilustruhet në tablën dhe grafikun në vijim:

Shpërndarja gjeografike e AL	Nr. i AL
• Tiranë	169
• Durrës, Elbasan	20
• Korçë, Pogradec	5
• Fier, Lushnjë, Berat	10
• Vlorë, Sarandë, Tepelenë	9
• Shkodër	9



Praktika profesionale e kandidatëve për Auditues Ligjorë më 31.12.2019


- ❖ 135 kandidatë po kryejnë praktikën profesionale për auditues ligjor, nga të cilët 102 kandidatë janë femra, ndërsa 33 janë meshkuj.

102 femra



33 meshkuj


- ❖ Angazhimi i kandidatëve në praktikën profesionale është zhvilluar sipas marrëveshjes me kontratë pune me kohë të plotë (3 vjeçare) dhe me kontratë pune me kohë të pjesshme (5 vjeçare). Kandidatët që kryejnë praktikën profesionale për auditues ligjor sipas llojit të marrëveshjes janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Pranimi i kandidatëve në praktikën profesionale për vitet 2016-2019 është si më poshtë:

- në vitin 2016 u pranuan 53 kandidatë, nga të cilët 38 femra dhe 15 meshkuj
- në vitin 2017 u pranuan 21 kandidatë, nga të cilët 13 femra dhe 8 meshkuj
- në vitin 2018 u pranuan 19 kandidatë, nga të cilët 18 femra dhe 1 meshkuj
- në vitin 2019 u pranuan 43 kandidatë, nga të cilët 28 femra dhe 15 meshkuj


Paraqitja grafike e regjistrimit të kandidatëve në praktikën profesionale është si në vijim:



Regjistrimi i kandidatëve për hyrjen në praktikën profesionale u bë në periudhën nga data 1 deri 15 Nëntor 2019 në zbatim të Rregullores së Edukimit. Duke filluar nga viti 2017 kandidatët zhvillojnë praktikën profesionale nën udhëheqjen e Audituesit Ligjor **vetëm me marrëveshje dhe kontratë pune me kohë të plotë 3 vjeçare**. Pranimet në praktikën profesionale gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 kanë patur tendencë në rritje.

- ❖ Në vitin 2019 numri total i personave të cilët kanë aplikuar për t'u pranuar si kandidatë në praktikën profesionale krahasimisht me vitet 2017 dhe 2018 është rritur përkatësisht me 44% dhe 48 %.
- ❖ Kandidatët që zhvillojnë praktikën profesionale në vitin 2019 që i përkasin grupmoshës 25-34 vjeç mbulojnë 52% të totalit të kandidatëve dhe ata që i përkasin grupmoshës 35-44 vjeç mbulojnë 38% të totalit.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i kandidatëve që zhvillojnë praktikën profesionale i ndarë sipas grupmoshës:



Tendenca në rritje e kërkesave për praktikën profesionale për këto grupmosha është tregues i interesit të gjeneratave të reja, të cilët kanë përfunduar ciklin e studimeve universitare në nivelin e dytë (Master) dhe duan të thellojnë njohuritë në fushën e profesionit të auditimit.

Kandidatët e pranuar në praktikën profesionale 2019 kanë përfunduar ciklin e studimeve universitare në nivelin e dytë (Master) si vijon:

- 44 % e kandidatëve gjatë 5 viteve të fundit,
- 25% e kandidatëve gjatë 10 viteve të fundit.

Kandidatët e pranuar në praktikën profesionale 2019 kanë përfunduar ciklin e studimeve universitare në nivelin e dytë (Master) në universitetet në vijim:

- 30 kandidatë në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës,
- 18 kandidatë në Fakultetin e Ekonomisë në qytetin e Durrësit, Vlorës, Shkodrës dhe Elbasanit, Jo-Publike në Tiranë
- 4 kandidatë në Universitetet e Ekonomisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqisë, Italisë dhe Hollandës.

Nga 135 kandidatë që kryejnë praktikën profesionale:

- 67 kandidatë e kryejnë praktikën profesionale pranë Audituesve Ligjorë të regjistruar si person fizik
- 68 kandidatë e kryejnë praktikën profesionale pranë Audituesve Ligjorë të regjistruar në Shoqëri Auditimi.

- ❖ 80 % e kandidatëve e kryejnë praktikën profesionale në Qytetin e Tiranës, më pas renditet Durrësi dhe Vlora me 4% dhe më pas Elbasani me 3%, ndërsa 9% në qytetet e tjera.

Në grafikun në vijim paraqitet shpërndarja gjeografike e kandidatëve:

Shpërndarja gjeografike e kandidatëve	Nr i Kandidatëve
• Tiranë	109
• Durrës	6
• Elbasan	5
• Fier	1
• Lushnje	1
• Vlorë	6
• Sarandë	3
• Shkodër	3
• Pogradec	1
• Totali	135

Kandidatët që kryejnë praktikën profesionale të ndarë sipas viteve dhe llojit të marrëveshjes/kontratës së punës në fund të vitit 2019, kandidatët paraqiten si në tabelën në vijim:


	Marrëveshje me kontratë punësimi 3 vjeçare	Marrëveshje me kontratë punësimi 5 vjeçare	Gjithsej
Viti I	44		44
Viti II	20	1	21
Viti III	27	3	30
Viti IV	6	7	13
Viti V	5	22	27
Gjithsej	102	33	135


Numri i kandidatëve që kryejnë praktikën profesionale me marrëveshje/kontratë pune 5 vjecare për vitin 2019 ka një trend në ulje prej 40% në krahasim me vitin 2018. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i:

- Shfuqizimit nga viti 2017 i marrëveshjeve/kontratave 5 vjecare për shkak të ndryshimeve ligjore/rregullatore
- Pakësimit të viteve që i kanë mbetur kandidatëve që kryejnë praktikën profesionale me marrëveshje/kontratë pune 5 vjecare

Marrëveshjet për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë shërbimi kanë përfunduar në vitin 2018.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat për praktikën profesionale të ndara sipas viteve dhe llojit të marrëveshjes:





Kualifikimi Vijueshëm i Anëtarëve dhe Edukimi i Kandidatëve

Në zbatim të programit të punës për vitin 2019, i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i IEKAs, Komiteti i Edukimit të Kandidatëve (KEK) dhe Kualifikimit të Vijueshëm (KKV), kualifikimi i vijueshëm është kryer nga lektorë profesionistë me eksperiencë, duke synuar rritjen e cilësisë së kualifikimit të anëtarëve dhe kandidatëve tanë. Programi i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve është hartuar duke marrë në konsideratë edhe propozimet e ndryshme nga anëtarët e IEKAs. Komiteti i Kualifikimit të Vijueshëm në bashkëpunim me stafin ekzekutiv ka organizuar gjatë vitit 2019, dy sesione të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKAs.

Kualifikimi i Vijueshëm i Anëtarëve të IEKA-s

Në datën 30 Janar 2019, në sallën e trajnimit në IEKA u organizua trajnimi lidhur me adresimin e rekomandimeve të Komitetit Moneyval në kuadër të luftës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, bazuar në bashkëpunimin e IEKA me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP). Në këtë trajnim u trajtuan çështjet më poshtë:

- ❖ Informacioni i përmbledhur për rekomandimet që kanë të bëjnë me fushën e audituesve ligjorë;
- ❖ Konkluzionet e vlerësimit kombëtar të riskut PPP/FT;
- ❖ Prezantimi i rasteve konkrete nga praktika vendase apo ndërkombëtare;
- ❖ Prezantimi në lidhje me vlerësimin individual të riskut PPP/FT;
- ❖ Përmbledhje e shkurtër e masave që subjektet duhet të marrin në kuadër të vigjilencës së duhur/zgjeruar.

Për anëtarët pjesëmarrës në këtë trajnim, me vendim të KD, u konsiderua 3 orë kualifikim i vijueshëm profesional

Sesioni i parë i Kualifikimit të Vijueshëm u mbajt në datat **12, 13 dhe 14 Qershor 2019** në mjediset e Hotel Partner dhe Universitetit Ismail Qemali në qytetin e Vlorës.

U zhvilluan gjithsej 3 ditë/ 18 orë kualifikim, ku u trajtuan temat në vijim:

- ❖ Pack SMEs/ Paketa e auditimit për Entitetet e Vogla dhe të Mesme
- ❖ Ndryshimet në Legjislacionin Tatimor
- ❖ Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare (i ndryshuar)
- ❖ Raste Praktike të çështjeve të auditimit
- ❖ Kodi Etikës i IFAC
- ❖ Legjislacioni Tregtar



Më 14 Nëntor 2019, në ambjentet e Hotel Tirana International, IEKA (Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar) në bashkëpunim me ACCA (Association of Chartered Certified Accountants) organizoi Konferencën e përbashkët me temë “Future of the Finance Profession”, i cili u konsiderua 2 orë kualifikim i vijueshëm për audituesit ligjorë pjesëmarrës në konferencë.



Sesioni i II i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve 5 ditë/ 26 orë u zhvillua në datat **22, 23, 25 Nëntor dhe 2-3 Dhjetor 2019** (për njërin grup) dhe në datat **2-6 Dhjetor 2019** (për grupin tjetër) në ambjentet e Hotel Tirana International.

Në këtë sesion u trajtuan temat e mëposhtme:

- ❖ Ndryshimet më të fundit në Legjislacionin Fiskal
- ❖ Prezantimi i Programit epAudit
- ❖ Prezantimi i Programit dhe Moduleve të Caseware WP
 - Prezantimi i panelit të punës
 - Prezantimi i Rastit Studimor
- ❖ Rasti Studimor: Krijimi i një angazhimi të ri
- ❖ Rikujtesë për SNA
- ❖ Rasti Studimor: Planifikimi dhe vlerësimi i rrezikut
- ❖ Rikujtesë për SNA
- ❖ Rasti Studimor: Përgjigja ndaj rrezikut
- ❖ Rikujtesë për SNA
- ❖ Rasti Studimor: Përfundimi dhe Raportimi

Duke e konsideruar me interes për anëtarët e IEKAs, marrjen e njohurive për një program auditimi, për anëtarët që shprehën interesin dhe përfituan licensën për përdorimin e programit dhe moduleve të Caseware Working Paper si dhe për të gjithë anëtarët e tjerë, me vendim të Këshillit Drejtues të IEKAs u miratua programi 5 ditor lidhur me Edukimin e Vijueshëm Profesional - Sesionin e dytë 2019.

Sipas programit të miratuar u realizuan edhe 2 orë trajnim mbi ndryshimet më të fundit në paketën fiskale 2020, 2 orë prezantim të programit Caseware Working Paper si dhe 2 orë prezantim për demonstrimin të programit të auditimit Ep Audit. Gjatë 4 ditëve të tjera u trajtuan elementë të auditimit modern sipas SNA-ve (sipas programit 1,3), përmes përdorimit të programeve dhe metodologjive të bazuara në teknologji, të shoqëruar me rast studimor (dosje praktike auditimi).



Me qëllim rritjen e efektivitetit të tij dhe për tju ardhur në ndihmë anëtarëve, kualifikimi do të realizohet në grupe më të vogla si dhe duke nxitur diskutimet dhe bashkëveprimin e pjesëmarrësve.

Kualifikimi i Kandidatëve të IEKA-s

Kualifikimi i kandidatëve për Auditues Ligjor. Edhe gjatë vitit 2019, IEKA organizoi tre seanca trajnimi për kandidatët sipas viteve të praktikës profesionale.

VITI I PARË	VITI I DYTË	VITI I TRETË
Më 11 Korrik 2019 për herë të parë u realizuar Trajnimi i kandidatëve të vitit të parë, i cili filloi në muajin korrik 2019 me modulën profesional (niveli i avancuar) në lëndën “Raportimi Financiar i Avancuar”	Nga datat 15.07.2019 – 20.07.2019 u zhvillua trajnimi për kandidatët e vitit të dytë bazuar në programin e miratuar nga Këshilli Drejtues, ku fokusi ishin Njohuritë mbi Raportimin Financiar - SNK/SNRF & Auditim Dhënie	Nga datat 8.07.2019 – 13.07.2019 u zhvillua kualifikimi i detyrueshëm për kandidatët e vitit të tretë (30 kandidatë) bazuar në programin e miratuar nga Këshilli Drejtimit – ku fokusi ishin Standardet



113 orë kualifikim

Në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues të IEKAs Nr 37 datë 20.09.2017 për miratimin e Kurikulës së Profesionit të Audituesit Ligjor me konsulencën e projektit të BB, në muajin Korrik 2019 nisi për herë të parë kualifikimi i 43 kandidatëve të vitit të parë 2019 me modulet profesionale sipas Kurrikulës së Profesionit të AL (Niveli Profesional i avancuar), të cilat kryhen vetëm nga organizata profesionale e Audituesve Ligjorë.

Trajnimi i kandidatëve të vitit të parë filloi në muajin korrik 2019 me modulën profesional (niveli i avancuar) në lëndën “Raportimi Financiar i Avancuar” dhe do të vazhdojë gjatë

3 viteve të praktikës profesionale me modulet më poshtë:

- Tatime dhe Taksa – Nivel i Avancuar
- Legjislacioni i Avancuar

- Drejtimi i Performancës i Avancuar
- Auditim & Dhënie Sigurie – Nivel i Avancuar
- Etika Profesionale

Përpara nisjes së trajnimit të moduleve profesionale u përkthyen prezantimet në formatin powerpoint sipas tekstit P2 (Corporate Reporting, botimet KAPLAN). Materialet e trajnimit u përkthyen nga stafi i IEKAs dhe u rishikuan nga lektorët e angazhuar në trajnime së bashku me ushtrimet praktike dhe rastet studimore. Ka përfunduar përkthimi i të gjithë kapitujve të tekstit CORPORATE Reporting P2.

Vlen të theksohet se në kuadër të projektit të BB “Support IEKA with financing for translation of training materials” me Nr Ref. No AL-EQ-FINREP/1.5-CS/IC janë përkthyer nga përkthyes të kontraktuar tekstet e Kaplan për librat APM (e plotë) dhe AAA (½ e tekstit).

Trajnimi për Modulin e Raportimit Financiar të Avancuar nisi në muajin korrik 2019 sipas programit.

Nisur nga fakti se Standardet Kombëtare të Kontabilitetit kanë një zbatim më të madh në vendin tonë, me propozim të KEKV, me miratim nga Këshilli Drejtues i IEKAs të datës 8.11.2019, kandidatët që kryejnë praktikën profesionale të vitit të parë 2019 zhvilluan 5 ditë/20 orë kualifikim për Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Në shtator 2019 ka përfunduar mandatin Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm (KEKV). Nga tetori 2019, për një periudhë 4 vjecare, ka filluar mandatin Komiteti i ri i KEKV.

Gjatë vitit 2019 KEKV ka shqyrtuar dhe miratuar vendime lidhur me kandidatët që kryejnë praktikën profesionale, të grupuara si më poshtë:

- Vlerësimi i aplikimeve të personave që kanë shprehur interes për t’u pranuar si kandidatë në praktikën profesionale dhe miratimi i marrëveshjeve të nënshkruara me Auditues Ligjorë.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të kandidatëve si, ndërprerje të marrëveshjes së praktikës profesionale, kryerjen e orëve shtesë të praktikës profesionale, ndryshimin e drejtuesit të praktikës, etj.
- Vlerësimi i kryerjes nga kandidatët, të detyrimeve të parashikuara nga Ligji 10091 (i ndryshuar) dhe rregullorja e edukimit (trajnime, testime/ritestime dhe mbrojtja e punimit profesional për kandidatë në vitin e fundit të praktikës profesionale 2019.
- Vlerësimi i aplikimeve për përjashtime nga praktika profesionale për individë me 15 vite eksperiencë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit dhe për përjashtime nga dhënia e disa provimeve për audituesit e huaj si mbajtes të titullit ACCA.

Numri i kandidatëve që kanë përsëritur praktikën profesionale krahasuar me vitin e kaluar është ulur me 5 % dhe numri i kandidatëve të ç’regjistruar nga praktika profesionale është e njëjtë me vitin e mëparshëm me 8 %. Disa nga arsyet për të

cilat kandidatët kanë përsëritur praktikën profesionale janë:

- Nuk kanë dorëzuar dokumentat që vërtetojnë kryerjen e praktikës profesionale (ditarët dhe kopje të listëpagesave që vërtetojnë punësimin e rregullt në pajtim me kërkesat e parashikuara në rregulloren e Edukimit dhe Kualifikimit Profesional) për më shumë se dy vite rresht.
- Nuk kanë frekuentuar trajnimet e detyrueshme të praktikës profesionale ose nuk kanë rezultuar fitues në testimet/ritestimet e zhvilluara në më shumë se dy vite.
- Kandidatët kanë kërkuar vetë ndërprerjen e praktikës profesionale.

Kryerja e praktikës profesionale në kushtet e punësimit me kohë të plotë synon që kandidati të përfshihet më shumë se më parë në thellimin e njohurive praktike për procedurat e auditimit ligjor të pasqyrave financiare. Pavarësisht këtij përmirësimi të arritur si rezultat i ndryshimeve ligjore, vërehet se ka ende mangësi dhe në disa raste formalizëm në kryerjen e praktikës profesionale.

Komiteti i Edukimit dhe kualifikimit të vijueshëm (KEKV) dhe Njësia e Edukimit të Kandidatëve për vitin 2020 synon përmirësimin

në fushën e edukimit të kandidatëve me fokus vazhdimin e zbatimit të Programit të Edukimit sipas Kurrikulës së re të profesionit të Audituesit Ligjor:

- Hartimin një plani mësimor bashkë me materialet mbështetëse të Modulit “Taksim i Avancuar” dhe Moduli “Legjislacion i Biznesit i Avancuar” përshtatur si për nivelin Master por edhe Bachelor. Për Modulin e Auditimit dhe Dhënies së Sigurisë do të rishikohet plani mësimor në mënyrë që të përfshihen edhe disa tema nga Niveli i Ndërmjetëm i Kurrikulës (do të shtohen tema për parimet bazë të Auditimit).
- Në kushtet e pandemisë Covid-19, trajnimi i kandidatëve po zhvillohet online nëpërmjet platformës ZOOM dhe platforma Google Classroom po përdoret për shkarkimin e materialeve.
- Informacione të vazhdueshme lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale të kandidatëve kanë qenë dhe do të jenë pjesë e publikimeve dhe njoftimeve në faqen web të IEKAs.



Sigurimi dhe Kontrolli i Cilësisë

Për të realizuar procesin e kontrollin e cilësisë, Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetin e Kontrollit të Cilësisë, përbërja e të cilit është si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Arqile Mishtaku | Kryetar |
| 2. Vera Lala | Anëtar |
| 3. Erjon Pjeternikaj | Anëtar |
| 4. Brunilda Stefa | Anëtar |

Me krijimin e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë në Tetor 2019, IEKA iu drejtua përsëri Bordit të Mbikëqyrjes Publike me kërkesën për delegimin e kryerjes së kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik (JoEIP), duke argumentuar se plotëson kërkesat e kritereve të ligjit dhe për realizimin e këtij procesi:

- ✓ ka reformuar Komitetin e Cilësisë,
- ✓ ka një paketë të plotë të rregullave të kontrollit të cilësisë të cilat janë hartuar bazuar në eksperiencën e deritanishme dhe me ndihmën e konsulentit të projektit të BB,
- ✓ ka përgatitur një listë të audituesve ligjorë që nuk ushtrojnë profesionin nga e cila do të përzgjidhen Inspektorët e Kontrollit të Cilësisë.

IEKA synoi që në vitin 2019 të realizonte kontrollin e cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik (JoEIP) përmes kontrollit të dosjeve të auditimit, duke bërë një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e auditimit, me kërkesat e etikës dhe të pavarësisë, një vlerësim të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara,

të tarifave të auditimit të ngarkuara dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë audituese (kabinetit në rastin e personit fizik).

Në ligjin e auditimit 10091 datë 05.03.2009 të ndryshuar me ligjin 47/2016 përcaktohet se, sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë përfshin dy hallka:

- a) kontrollin e cilësisë, që organizohet brenda shoqërisë së auditimit;
- b) kontrollin e cilësisë, që organizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Kontrolli i cilësisë brenda firmës/kabinetit të auditimit duhet të garantohet përmes vendosjes së rregullave të brendshme të rishikimit për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimeve, të cilat bazohen në SNKC1 dhe në udhëzimet përkatëse të përpunuara nga IEKA.

Procedura e kontrollit të cilësisë përcakton se kontrolli i cilësisë kryhet në bazë të një analize risku:

- të paktën një herë në çdo tre vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë ekonomike me interes publik;
- një herë në çdo gjashtë vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë e tjera ekonomike;
- një herë në dy vjet, derisa arrihet eksperiencia e kërkuar për audituesit ligjorë, me jo më shumë se pesë vjet përvojë pune në profesion.

Në vazhdim të përpjekjeve për të marrë nga BMP delegimin për kontrollin e cilësisë për JoEIP, IEKA po përgatit edhe:

- Një paketë të rregullave për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të tjera.
- Organizimin e komitetit të kontrollit të cilësisë për verifikimin e zbatueshmërisë së standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore nga Audituesit Ligjorë.

Materiali me rregulla për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të kryera është marrë nga organizata profesionale FCM dhe është përkthyer nga IEKA.

Komiteti i Standardeve Profesionale

Anëtarët e Komitetit të Standardeve Profesionale, bazuar në nenin 21, të statutit të IEKAs, u miratuan me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 36 datë 17.10.2019.


Përbërja e Komitetit të Standardeve Profesionale:

- | | |
|-----------------|---------|
| 1. Berti PASHKO | Kryetar |
| 2. Artan XHIANI | Anëtar |
| 3. Hysen ÇELA | Anëtar |



Fokusi kryesor i këtij komiteti do të jetë trajtimi i çështjeve dhe kërkesave për interpretim lidhur me zbatueshmërinë e standardeve profesionale dhe të kodit të etikës.

Investigimi dhe Disiplina



Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës për vitin 2019, ka kryer disa procese investigimi nisur nga kërkesa - ankesa të ndryshme të ardhura në Institut ndaj anëtarëve të tij. Në përputhje dhe me objektivin e tij kryesor, ky komitet investigon sjelljet e anëtarëve të IEKA-s që bien në kundërshtim me:

- dispozitat e ligjit “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar);
- aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- aktet statutore të organizatës; dhe me
- standardet profesionale dhe kodin e etikes.

Përbërja e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, për vitin 2019 rezulton si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1. Shkëlzen Margjeka | Kryetar |
| 2. Elton Tirana | Anëtar |
| 3. Majlinda Maqellari | Anëtar |

Ankesat drejtuar Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës gjatë këtij vitit kanë të bëjnë kryesisht me çështjet si më poshtë:

- Evidentimi i një shoqërie (jo anëtare e IEKAs) të regjistruar në QKB me objekt të veprimtarisë "Auditim të Pasqyrave Financiare", e cila mund të ketë lëshuar raporte auditimi pa u pajisur me licensë

profesionale dhe pa u regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs;

- Moszbatimi i kërkesave të Kodit të Etikës dhe procedurave të auditimit gjatë ushtrimit të profesionit të AL.

Në përfundim të procedurave të investigimit të realizuara nga anëtarët e tij, KID ka hartuar relacionet dhe ka marrë vendimet përkatëse të cilat i janë përcjellë për vendimmarrje përfundimtare Këshillit Drejtues të IEKAs.

Me gjithë përpjekjet e shumë anëtarëve për të respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, të rregulloreve, të statutit, si dhe kodit të etikës të IEKAs, përsëri në praktikë vazhdojnë të vërehen raste kur këto kërkesa nuk zbatohen plotësisht. Mangësi vërehen në procedurat e marrjes përsipër të angazhimeve/misioneve, në zbatimin e tarifave të ulëta, jo-konkurruese dhe të pamjaftueshme për një auditim cilësor sipas SNA-ve, deklarime të pasakta në IEKA të angazhimeve të kryera dhe në veçanti mosdeklarimi i angazhimeve të ndryshme nga auditimi, siç janë raportet e ekspertëve për prokurorinë, gjykatën, raporte dhe shërbime të tjera, të cilat potencialisht mund të dëmtojnë profesionin e Audituesit Ligjor, nëse nuk respektojnë të njëjtën kërkesë etike sikurse edhe shërbimet e tjer


Publikime

Gjatë vitit 2019, Këshilli Drejtues i IEKAs vendosi rifillimim e botimit të revistës "Kontabilitet, Financë & Auditim" me numrin e saj të 39-të.

Revista "Kontabilitet, Financë & Auditim" u botua më datë 20 Dhjetor 2019. Promovimi dhe shpërndarja e saj u realizua në takimin e fundvitit të organizuar nga IEKA në ambjentet e Hotel Tirana International.

Anëtarët e IEKAs u njoftuan me e-mail dhe nëpërmjet publikimit në faqen web për botimin nr. 39 të revistës dhe u inkurajuan që të kontribuojnë për të pasuruar botimin e saj me artikuj, opinione, mendime e sugjerime në lidhje me profesionin.

Në brendësi të numrit të 39-të të revistës "Kontabilitet, Financë & Auditim" qëndrojnë shkrime që trajtojnë disa prej temave më të rëndësishme në ditët e sotme



për profesionin e audituesit dhe të kontabilistit, me autorë Auditues Ligjorë, bashkëpunëtorë të IEKAs dhe akademikë. Në këtë drejtim, vëmendje e duhur iu kushtua ndikimit që ka teknologjia dhe dixhitalizimi në të ardhmen e profesionit si një prej çështjeve më aktuale dhe thelbësore për profesionistët kontabël. Pjesë e revistës janë gjithashtu edhe artikuj të tjerë nga fusha e auditimit dhe raportimit financiar, ku vlen të veçohen temat:

- **Pse cilësia e raportimit financiar stimulon rritjen ekonomike?**
- **Kuadri i IAASB për angazhimet e sigurisë, garanci për shërbime profesionale cilësore.**
- **Domosdoshmëria e hartimit dhe publikimit të materialeve udhëzuese për zbatimin dhe interpretimin e kërkesave të standardit për marrëveshjet konçensionare.**
- **Auditimi në epokën dixhitale**

Revista "Kontabilitet, Financë & Auditim" synon publikimin e shkrimeve dhe materialeve të ndryshëm për t'i ofruar anëtarëve të saj tema sa më informuese dhe aktuale që nxisin diskutimin lidhur me të ardhmen e profesionit. Kjo revistë ka karakter kryesisht profesional në të cilën botohen shkrime nga fusha e kontabilitetit, financës, jurisprudencës, taksave, tatimeve si dhe materiale të tjera të ngjashme. Brenda faqeve të saj mund të botohen gjithashtu, artikuj të tjerë informues të dobishme për anëtarët e Institutit dhe jo vetëm, dhe në këtë funksion IEKA do të vazhdojë punën e saj për publikimin e numrave të ardhshëm të revistës edhe gjatë vitit 2020.

Veprimtari me Organizmat Kombëtare



Viti 2019 njohu një rritje të mëtijshme të komunikimit të IEKAs me institucionet e pavarura dhe organet e tjera të administratës publike. Ky bashkëpunim i ka shërbyer rritjes dhe fuqizimit të rolit të profesionit, përmirësimit të cilësisë së punës dhe veçanërisht mbrojtjes së anëtarëve dhe të interesit publik. Zhvillimet ekonomike shoqërore të vendit e bëjnë gjithnjë e më të domosdoshme bashkëpunimin, në rradhë të parë midis anëtarëve apo segmenteve të ndryshme të profesionit dhe padyshim edhe me rregullatorët dhe aktorët e tjerë të pavarur e publikë. Thellimi i bashkëpunimit me organizatat e kontabilitetit në vend (IKM, SHKFSH, SHKM, etj.), Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Integritetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Universitetet (FEUT, UBT, etj.), me Dhomat e avokatisë dhe të tregtisë, si edhe me shumë organe të tjera të administratës publike, ka njohur një shkallë mjaft cilësore gjatë gjithë vitit të kaluar.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka ushtruar funksionin e tij të mbikëqyrjes së profesionit të AL dhe shoqërive audituese. IEKA ka qenë në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me BMP. Gjithashtu BMP-ja ka ushtruar detyrën e tij mbikqyrëse mbi veprimtarinë e anëtarëve të Institutit nëpërmjet kontrollit të cilësisë.

IEKA ka marrë pjesë aktive në veprimtaritë profesionale të organizuara në vend.

Aktivitete me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)

Më 30 janar 2019, IEKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) realizoi një trajnim në sallën e trajnimit në IEKA lidhur me rekomandimet e Komitetit Moneyval në kuadër të luftës për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Aktivitete të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit

- **Më datë 15 Maj 2019** në ambjentet e Hotel Tirana International, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë "Ligji i ri për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 dhe zbatueshmëria e tij" në të cilën

- morën pjesë edhe përfaqësues të IEKAs. Në këtë tryezë u diskutuan mbi nevojën e hartimit të një komentari në zbatim të ligjit të ri të kontabilitetit si dhe disa problematika të mundshme që mund të hasen në zbatueshmërinë e tij, të cilat do të kërkojnë ndërhyrjen e Institucioneve përgjegjëse për zbatueshmërinë e këtij ligji apo hartimin e të tjera akteve nënligjore që lidhen me të. Ndër të tjera, në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të njësive të ndryshme ekonomike, shoqatave profesionale, shoqërive të auditimit, organizmave rregullatorë, MFE, KLSH, etj.
- **Më datë 12 Korrik 2019,** Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë

“Rregullorja e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve” në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të IEKAs. Diskutimet e tryezës u fokusuan mbi rëndësinë e përgatitjes së një rregulloreje në ndihmesë të njësive ekonomike duke përmbledhur në parim procedurat e inventarizimit sipas objektit të inventarizimit, si dhe përfshirjen e disa formularëve tip shumë të rëndësishëm për inventarizimin kryesisht të aktiveve afatgjata materiale. Në këtë tryezë morën pjesë profesionistë të ndryshëm që ushtrojnë profesionin e kontabilistit në njësi ekonomike apo si të licencuar, auditues ligjorë si dhe përfaqësues nga bota akademike.



Veprimtaritë me Organizmat Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2019, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar vijoi traditën e tij me konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me organizmat profesionale ndërkombëtare ku IEKA është anëtare aktive me të drejta të plota, siç janë:

FCM (*Federata e Ekspertëve Kontabël të Mesdheut*)

FCM është një shoqatë e krijuar në fund të vitit 1999 me iniciativën e drejtuesve të organizatave profesionale të vendeve të Mesdheut. Ajo mbledh së bashku organizatat profesionale të cilat veprojnë në vendet e Mesdheut dhe promovon bashkëpunimin midis organizatave profesionale në rajon, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, për të ndarë njohuritë dhe për të ofruar ndihmë teknike për anëtarët e saj dhe për t'i ndihmuar ata të arrijnë dhe mbajnë standarde të larta profesionale dhe të dhënies së sigurisë. IEKA është anëtare e FCM nga viti 2006.

Mbledhja e Këshillit të FCM u mbajt në datë 25 janar 2019, në qytetin e Lisbonës (Portugali) në të cilën IEKA ishte pjesëmarrëse. Mbledhja u fokusua në diskutimet mbi strategjinë dhe planet e aktiviteteve të ardhshme të FCM duke u ndalur në rezultatet e mbledhjes së grupit të punës për kontrollin e cilësisë si dhe në diskutime mbi buxhetin e FCM. Ndër të tjerë në këtë mbledhje të Këshillit të FCM morën pjesë përfaqësues të CSOEC & CNCC Francë, ACCA, SCAAK etj.

EFAA (*Federata Europiane e Kontabilistëve dhe Audituesve për SME-të*)

EFAA është një organizatë e krijuar në 1994 e cila mbledh së bashku të gjitha organizatat ndërkombëtare të kontabilistëve dhe audituesve anëtarët e së cilave sigurojnë shërbime profesionale kryesisht për Entitetet e Vogla dhe të Mesme në Europë. EFAA përbëhet nga 17 anëtarë që përfaqësojnë rreth 320,000 kontabilistë dhe auditues në të gjithë Europën. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është anëtare me të drejta të plota në EFAA që nga viti 2016.

Konferenca Ndërkombëtare dhe Asambleja e Përgjithshme e EFAA u mbajtën në datat 27 dhe 28 qershor 2019, në Amsterdam (Hollandë), ku morrën pjesë edhe përfaqësues të IEKAs. Konferenca e EFAA me temë “Ndërtimi i Praktikës Dixhitale” trajtoi disa nga çështjet më aktuale për botën e kontabilitetit ku mund të përmendim rreziku ndaj krimeve kibernetike, rëndësia e teknologjisë dixhitale për SME-të, ndryshimi i shërbimeve të ofruara nga SMP-të për t'u përshtatur ndryshimeve teknologjike etj. Ndërsa në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme vlen të përmendet zgjedhja e presidentit të ri të EFAA, z. Salvador Marin.

MIA (Instituti i Kontabilistëve të Maltës) në bashkëpunim me **ICAEW** (Institutin e Kontabilistëve të Çertifikuar të Anglisë dhe Uellsit)

Instituti i Kontabilistëve të Maltës (MIA) në bashkëpunim me **Institutin e Kontabilistëve të Çertifikuar të Anglisë dhe Uellsit (ICAEW)** në datën 11 prill 2019, organizuan Forumin Strategjik për Profesionistët Kontabël, ku morën pjesë edhe përfaqësues të IEKAs. Në fokus të këtij forumi ishin shqyrtimi i rolit të organizatave profesionale në çështjet dhe sfidat kryesore me interes publik, rritja e integritetit financiar në ekonomitë vendase, si dhe përshtatja me ndryshimet teknologjike. Pjesë e këtij forumi ishin edhe diskutimet mbi marrëdhëniet e organizatave profesionale me autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, publikun, grupet e interesit si dhe anëtarët e vetë organizatave profesionale.

Projekti i Bankës Botërore “Support IEKA members to increase capacity and knowledge on ISAs application through training programs, including tools and methodologies”, në kuadër të projektit kombëtar “Përmirësimi të cilësisë së raportimit financiar (REPARIS)” mundësoi organizimin e takimeve me përfaqësues të IEKAs, shoqërive të programeve kompjuterike dhe konsulentit për përzgjedhjen e programit kompjuterik të auditimit të bazuara në SNA-të e IAASB-së, respektivisht Caseware dhe Datev. Caseware dhe Datev janë programe auditimi të njohura në tregun europian, të cilat ofrojnë një platformë gjithëpërfshirëse në ndihmesë të procedurave të auditimit. Në rolin e konsulentit për këtë projekt ishte shoqëria e auditimit Grant Thornton. Takimet u zhvilluan në datat 8 dhe 24 maj 2019, në Munich dhe Amsterdam.

CAG (Grupit Këshillues Konsultativ i IESBA dhe IAASB)

Mbledhjet e CAG IESBA dhe IAASB u zhvilluan në datat 8-12 Shtator 2019 në New York (SHBA). Përfaqësues të IEKAs morën pjesë në mbledhjet e Grupit Këshillues Konsultativ (CAG) të IESBA dhe IAASB. CAG është pjesë e rëndësishme e procesit të hartimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, të Kontrollit të Cilësisë, Etikës dhe shërbimeve të tjera profesionale. CAG ka në përbërje të tij përfaqësues të BB, Komisionit Europian, IASB, NASBA, IOSAI, etj, të cilët janë të interesuar në zhvillimin dhe mbajtjen e cilësisë së lartë të standardeve ndërkombëtare profesionale dhe etike të hartuara për ti shërbyer interesit publik. Ndër të tjera programi i mbledhjeve u fokusua në diskutime mbi SNA 315 (i rishikuar), Menaxhimi i Cilësisë (ISQM 1), Teknologjia, Evidenca e auditimit, Planifikimi taksave etj.

FIDEF dhe CNCC

FIDEF është një organizatë e krijuar në vitin 1981 me iniciativën e disa profesionistëve nga vende të ndryshme. FIDEF përbëhet nga 52 anëtarë në 4 kontinente të cilët përfaqësojnë rreth 80,000 kontabilistë dhe auditues në të gjithë botën. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është anëtar me të drejta të plota në FIDEF që nga viti 2000.

Kongresi i 74 për Kontabilistët e Miratuar të organizuar nga FIDEF dhe CNCC u organizua në datat 25-27 Shtator në Paris (Francë), në të cilën morën pjesë përfaqësues të IEKAs. Tema kryesore e Kongresit ishte “Çfarë duhet të bëhet sot, për t’i paraprirë transaksioneve kontabël në të ardhmen?”. Punimet e kongresit u fokusuan në ndryshimet në ligjin francez (PACTE), “Plan Aksioni për Rritjen dhe Transformimin e Biznesit” dhe ndikimin e tyre në profesion.

ACCA

ACCA (Association of Chartered Certified Accountants) dhe IEKA kanë një marrëveshje bashkëpunimi. Në datën 14 Nëntor 2019 në ambjentet e Hotel Tirana International, IEKA (Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar) në bashkëpunim me ACCA (Association of Chartered Certified Accountants) organizuan Konferencën e përbashkët me temë “Future of the Finance Profession”, me fokus edukimin profesional në fushën financiare.

Në këtë konferencë morën pjesë komuniteti ACCA, anëtarët e IEKAs dhe përfaqësuesit e Universiteteve dhe Bizneseve në vend. Temat e prezantuara në konferencë lidheshin me disa nga projektet dhe raportet më të fundit të ACCA-së: “Si arsimimi mund të mbështesë të ardhmen e profesionistit financiar”, “Si e formojnë teknologjinë dixhitale dhe etikën e profesionistit financiar”, etj.

IFAC (Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve)

Që nga viti 2000, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është anëtarësuar në IFAC (Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve). Në vitin 2006 IEKA u bë anëtare me të drejta të plota.

IFAC është organizata që përfaqëson profesionin në rang ndërkombëtar, e dedikuar për t’i shërbyer interesit publik nëpërmjet forcimit të profesionit dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekonomive të fuqishme ndërkombëtare. IFAC përbëhet nga 175 anëtarë dhe bashkëpunëtorë në më shumë se 130 shtete që përfaqësojnë mbi 3 milionë kontabilistë në praktikën publike, edukim, shërbimin qeveritar, industrinë dhe tregtinë.

Mbledhja vjetore e Këshillit të IFAC u mbajt në Vancouver, Kanada më datën 13 – 14 Nëntor 2019. Në mbledhje morën pjesë drejtuesit e IEKAs. Qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte nxitja e bashkëpunimit, rritja e komunikimit dhe e koordinimit midis profesionistëve kontabël dhe audituesve ligjor në të gjithë botën. Në raportet të përgatitura nga Këshilli i IFAC synohet rritja e kontributit në udhëheqje për çështje të rëndësishme të tilla si sigurimi që në të ardhmen IFAC të ketë grupin e nevojshëm të kandidatëve për të përmbushur rolet e lidershit dhe pozitat e anëtarësimit në të gjitha bordet, komitetet, panelet dhe nënkomisionet e tij.

Në këtë mbledhje u miratuan nga pjesëmarrësit me të drejtë vote raportet në vijim:

- Raporti i Kryetarit të Komitetit të Auditimit, që përfshin rekomandimet për miratimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare 2018 dhe zgjedhjen e audituesit të jashtëm për vitin 2020.

- Raporti i Kryetarit të Komitetit të Financës dhe Planifikimit.
- Raporti i Shefit Ekzekutiv të Financës, ku një vëmendje të veçantë iu kushtua arritjeve të buxhetit 2019 dhe miratimit të parametrave dhe bazës së vlerësimit të buxhetit të vitit 2020.
- Raporti i Shefit të Komisionit për Qeverisjen mbi ndryshimet e propozuara në Kushtetutë dhe në aktet nënligjore.
- Raporti i Shefit të Komisionit të Emërimit, që trajtoi çështje të tilla si zgjedhjen e Bordit dhe miratimin e anëtarëve të Komitetit të Emërimit.
- Raporti i Drejtorit Ekzekutiv të IFAC, Kevin Dancey mbi implementimin e planit strategjik 2019-2020, zhvillimin dhe kohën e planit tjetër strategjik të IFAC si dhe procesin e rishikimit të grupit monitorues.



Një hapësirë e veçantë iu dedikua edhe prezantimit të njohurive, perspektivave dhe arritjeve kryesore të Bordit të Hartimit të Standardeve, Bordit Mbikëqyrës të Interesit Publik dhe Komitetit të Interesit Publik mbi tërësit më të fundit të fushës së tyre.

Në seksionin e miratimit të dokumentave të paraqitura në këtë mbledhje, çështja 8.1 në axhendën e mbledhjes të datës 12 Nëntor 2019, ishte pranimi i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë (IKM) si anëtar me të drejta të plota në IFAC.

Kryetarja e Këshillit Drejtues të IEKAs zj. Eleonora Olli me cilësinë e përfaqësueses të autorizuar, votoi për pranimin e Institutit të Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë (IKM) si anëtar me të drejta të plota në IFAC.

Struktura Ekzekutive

Stafi Ekzekutiv i IEKAs funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Këshilli Drejtues dhe të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës Ekzekutive të IEKAs, të miratuar me vendimin nr. 33 datë 05.11.2014 të KD dhe të rishikuar me vendimin nr. 49 datë 04.12.2019 të KD. Në këtë rregullore është përcaktuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës të stafit ekzekutiv. Modeli i strukturës së re është mbështetur në strukturën ekzistuese, por u riformatua për të mundësuar mbulimin më të mirë të funksioneve të IEKAs. Gjatë vitit 2018 dhe 2019 u bë e mundur rritja e numrit të punonjësve për tju përgjigjur më mirë kërkesave të anëtarësisë dhe detyrimeve ndaj organizatave ndërkombëtare ku IEKA është anëtare me të drejta të plota.

Struktura e personelit ekzekutiv e cila përbëhet nga:


Punonjësit me kohë të plotë:

- | | |
|--------------------|---|
| 1. Elvira Hoxha | Drejtor Ekzekutiv |
| 2. Elda Luga | Specialist Edukimi |
| 3. Valentina Sora | Specialist Edukimi dhe Finance Kontabiliteti |
| 4. Tedi Ziko | Specialist, Standardet profesionale |
| 5. Sara Shurdhi | Specialist, Standardet profesionale |
| 6. Eralda Kullolli | Sekretare |
| 7. Albana Pllaha | Detyra e mirëmbajtjes (pastrimit) të ambjenteve |

Punonjësit me kontratë shërbimi:

- | | |
|----------------|---------------------------------------|
| 1. Alida Daija | Specialist për Financë Kontabilitetin |
|----------------|---------------------------------------|

Struktura e stafit ekzekutiv të IEKAs sipas gjinisë:



Gjatë vitit 2019, stafi Ekzekutiv i IEKAs ka realizuar detyrat funksionale duke ndjekur Programin e Punës së KD për vitin 2019, si dhe detyrat e përcaktuara në kontratën individuale të punës. Për plotësimin e strukturës organizative të ekzekutivit të miratuar, prioritet për vitin 2020 mbetet plotësimi i stafit me një punonjësi të ri, angazhimi me kontratë shërbimi i 2-3 audituesve ligjorë joushtrues të profesionit për ti angazhuar si Inspektorë të KC si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit.

Informacioni i paraqitur për vitin 2019 jep një paraqitje të aktiviteteve të kryera nga IEKA bazuar në Ligjin 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të AL dhe të KM” (të ndryshuar), Statutin dhe rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Institutit.

Zhvillimi i burimeve njerëzore i shërben rritjes së kapacitetit profesional të punonjësve në përputhje me misionin dhe objektivat e IEKAs. Qëllimi kryesor mbetet zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve të stafit ekzekutiv, motivimi i tyre për arritjen e objektivave si dhe shtimi i burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.



Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare

Në përmbushje të detyrave të parashikuara në Ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) dhe në Statutin e IEKAs, paraqesim si më poshtë informacion për realizimin e buxhetit të Institutit për vitin 2019.

Bazuar në nenin 25 të Statutit, veprimtaria financiare e Institutit dhe zbatimi i procedurave kontabël verifikohet nga Komiteti i Kontrollit të Brendshëm. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve (vendimi nr. 142 datë 30.09.2019) dhe kanë mandat 4-vjeçar. Gjithashtu bazuar në nenin 25.2 të Statutit, Pasqyrat Financiare të IEKAs auditohen nga audituesit ligjorë të cilët janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve (vendimi nr. 136 datë 28.06.2018) dhe nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 31, datë 02.09.2019.

Buxheti i vitit 2019, sipas përcaktimit në nenin 8.1 të Statutit është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve e datës 28 qershor 2018 (vendimi nr. 132). Nga ana e KD i është kushtuar një kujdes i veçantë ndjekjes së aspekteve financiare jo vetëm në drejtim të ruajtjes së kufijve buxhetore por edhe në drejtim të gjetjes së mundësive të reja dhe përdorimit të burimeve me efikasitet maksimale, duke respektuar kërkesat e Ligjit, të Rregulloreve dhe të Statutit të IEKAs.

Në pjesën e dytë të raportit janë dhënë në mënyrë më të detajuar treguesit financiarë, ku është përfshirë dhe raporti i audituesve të pavarur. Këta tregues tregojnë kujdesin e Drejtimit dhe të KD për vlerësimin e çdo harxhimi financiar në funksion të domosdoshmërisë së tij dhe performancës aktuale e asaj të ardhme.

Realizimi i buxhetit të Institutit për vitin 2019 është bërë në përmbushje të detyrave të parashikuara në Ligjin 10091 datë 05.03.2009 (të ndryshuar) dhe në Statutin e IEKAs.

Burimet (të ardhurat) gjithsej për vitin 2019 nga 23.800.000 lekë të planifikuara janë realizuar 30.834.133 lekë ose në masën 130 %. Kontributi kryesor në grupin e të ardhurave i përket të ardhurave të paguara nga kuota fikse e anëtarësimit dhe ato nga kuota variabël. Të ardhurat nga kuota fikse përbëjnë 48.68 % të të ardhurave vjetore të Institutit, nga 54% që përbënin në vitin 2018, ndërsa të ardhurat nga kuota variabël përbëjnë 27% të të ardhurave vjetore, në të njëjtën përqindje si viti 2018.

Në krahasim me buxhetin e planifikuar të vitit 2019, ka rritje të konsiderueshme të të ardhurave të realizuara nga kuota variabël si rezultat i ndryshimit të llogaritjes së kuotës variable si dhe rritjes së shumës së angazhimeve të kryera nga anëtarët.

Përdorimet (Shpenzimet) gjithsej nga 30.471.820 lekë të buxhetuara, janë realizuar 29.934.594 lek ose 98%. Në buxhetin e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme është planifikuar që Teprica e burimeve të vitit financiar të jetë (6.780.820) lekë dhe në fakt është realizuar në shumën (1.092.309) lekë.

Shpenzimet e planifikuara për honoraret e komiteteve janë realizuar në masën 36% për shkak të mungesës së aktivitetit të tyre, vecanërisht të Komitetit të Cilësisë. Ka mosrealizim të buxhetit edhe në zërin e shpenzimeve të pagave për arsye se rekrutimi i stafit është bërë në fund të vitit 2019 dhe do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020. Me përfundimin e përkthimit dhe të rishikimit të Manualit Handbook Volumi I dhe III, si dhe i Kodit të Etikës së IFAC, do të vijojë punën me botimin e tyre.

Në shpenzimet e Kualifikimit janë përfshirë shpenzimet e kualifikimit të anëtarëve, të kandidatëve si dhe personave të interesuar për tu trajnuar në fushën e SKK/SNRF. Për arsye se anëtarët që ushtrojnë profesionin nuk janë ngarkuar me kostot e kualifikimit të vijueshëm, teprica e këtij zëri të shpenzimeve është negative.

Burimet dhe përdorimet e fondeve financiare të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për vitin 2019 janë realizuar si më poshtë:

	Buxheti 2019	Realizimi 2019	në %
Nga aktiviteti			
Të ardhura	19,950,000	27,913,999	140 %
Shpenzime	25,521,820	21,936,927	86 %
Teprica nga aktiviteti	(5,571,820)	5,977,072	
Botimet (Revista dhe të tjera)			
Të ardhura nga botimet	200,000	19,800	10 %
Shpenzime për botimet	1,900,000	408,576	22%
Teprica nga botimet	(1,700,000)	(388,776)	
Nga Kualifikimet			
Të ardhura	3,300,000	2,444,500	74%
Shpenzime	3,050,000	3,389,486	111%
Teprica nga kualifikimet	250,000	(944,986)	
Të ardhura nga depozitat	350,000	445,694	127%
Teprica nga kursi i këmbimit		(21,849)	
Aktiviteti sipas vendimit Asamblesë		(4,167,616)	
Shpenzime për tarifën 7% të BMP	(1.309.000)	(2.158.389)	
Teprica përfshirë investimin	(6,780,820)	(1,092,309)	

Pasqyrat Financiare të Audituar janë bashkëlidhur dhe janë pjesë e këtij raporti.

Objektivat për të ardhmen

Të dashur kolegë,

IEKA do të vazhdojë të kontribojë në përmirësimin e auditimit ligjor dhe shërbimeve profesionale në vend duke respektuar kërkesat ligjore, etike dhe pavarësinë. Për realizimin e objektivave në të ardhmen IEKA do të fokusohet në këto drejtime kryesore:

- Në zbatimin korrekt të standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore e rregullatore nga audituesit ligjorë me synimin e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të auditimit ligjor dhe të dhënies së sigurisë.
- Në vendosjen e theksit në rritjen e llojshmërisë së shërbimeve profesionale, ku auditimi i brendshëm, rishikimet, vlerësimi dhe raportimi mbi kontrollin e brendshëm, vlerësimi për rreziqet e biznesit, rreziqet e sektorit, vlerësimet e zhvillimeve afatgjatë, këshillat dhe vlerësimet për ndarjet e bashkimit, etj.
- Në vazhdimin e përpjekjeve për rritjen e besimit të publikut në profesionin e audituesit ligjor e cila arrihet nëpërmjet garantimit të cilësisë së lartë të kryerjes së shërbimeve profesionale si dhe respektimit të etikës dhe të pavarësisë.
- Në përmirësimin dhe zhvillimin e strukturës së kualifikimit të vijueshëm të audituesve ligjorë dhe kandidatëve duke u fokusuar gjerësisht në përdorimin e platformave online në kushtet e pandemisë dhe me grupe të vogla nëse zhvillohet me pjesëmarrje fizike.
- Në zhvillimin e procedurave dhe udhëzimeve për kryerjen e auditimit ligjor edhe në kushtet e punës nga shtëpia ose zyra.
- Në përditësimin dhe përmirësimin e Moduleve të reja të përgatitjes profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, të cilat bazohen në standardet më të mira ndërkombëtare.
- Në rritjen e kooperimit dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit me mbikqyrësin.
- Në finalizimin e përpjekjeve për delegimin nga Bordi të kontrollit të cilësisë për Jo-EIP,
- Në përmirësimin e formatit vjetor të deklarimit të angazhimeve profesionale të audituesve ligjorë.

- Në përmirësimin e formatit të regjistrit publik të audituesve ligjorë.
- Në përmirësimin e procedurës të zhvillimit të mbledhjeve vjetore të

asamblesë së anëtarëve dhe procedurës së votimit duke aplikuar metodat bashkëkohore tashmë të përdorura gjerësisht nga partnerët tanë si IFAC, FCM, EFAA, etj.

Shpreh besimin se mbajtja në nivelin që duhet dhe rritja e reputacionit të profesionit, kërkon përfshirjen e të gjithë palëve, bashkëpunim, punë dhe përpjekje të vazhdueshme si dhe kooperim të pandërprerë me institucionet brenda dhe jashtë vendit. Anëtarët e IEKAs, do të vijojnë të jenë të angazhuar dhe do t'i vlerësojnë sukseset e arritura në përmbushje të rolit të tyre për ofrimin e shërbimeve profesionale sa më cilësore dhe brenda kuadrit të parimeve themelore të Kodit të Etikës të IFAC-ut.

Shpresoj që së bashku të jemi një ekip që do të realizojmë objektivat e së ardhmes!

Berti Pashko

Kryetar i Këshillit Drejtues